



S T A T U T

I SHOQATËS

“ INSTITUTI I KONTABILISTËVE TË MIRATUAR “

KAPITULLI I

Te përgjithshme

Neni 1

Shoqata “ **INSTITUTI I KONTABILISTËVE TË MIRATUAR** “, është një grupim i krijuar me vullnetin e lire te profesionisteve qe janë pajisur me dëshminë “Kontabël i Miratuar”, si edhe te kandidateve qe dëshirojnë te aplikojnë për t’u pajisur me këtë Dëshmi.

Shoqata “ **INSTITUTI I KONTABILISTEVE TE MIRATUAR** “ është një organizate jo fitimprurëse, jo qeveritare, qe e ushtron veprimtarinë e saj duke u bazuar ne dispozitat e këtij statuti, ne Ligjin Nr. 10091, date 05.03.2009, “ Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe te Kontabilistit te Miratuar “ i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” i ndryshuar.

Neni 2

Emërtimi i plote është Instituti i Kontabilisteve te Miratuar.

Emërtimi i shkurtuar është IKM.

Selia e IKM është ne Tirane.

Adresa: Rruga Elbasanit, Pa. Edil – Al – It, Zyra Nr. 323 – Tirane.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë se IKM

- Te siguroje organizimin dhe drejtimin e përhershëm te specialisteve qe posedojnë dëshminë ” Kontabël i Miratuar ” si edhe kandidateve qe dëshirojnë te aplikojnë për t’u pajisur me dëshminë ” Kontabël i Miratuar ”,

- Te mbroje interesat profesionale te tyre, duke kërkuar garancitë e duhura për kompetencat, pavarësinë dhe bindjen profesionale.

- Te bashkërendojë punën me Këshillin Kombëtar te Kontabilitetit, me Bordin e Mbikëqyrjes Publike, Autoritetin e Çertifikimit, me Ministrinë e Financave dhe me organizma te tjerë te interesuara ne fushën e Kontabilitetit, për probleme te organizmit te Kontabilitetit, te dokumentacionit kontabël, për studime e punime ne përmirësimin e dispozitave ligjore te kontabilitetit, standardet e kontabilitetit, standardet profesionale,



rregullimet ligjore për profesionin, për organizimin e provimeve dhe pajisjen me Dëshminë “Kontabël i Miratuar” dhe të certifikatave dhe dëshmime të ngjashme, etj.

- Te organizoje dhe te krijojë lidhje dhe bashkëpunim me institucione e organizma homologe brenda e jashtë vendit.
- Te mbikëqyrë anëtarët e saj për zbatimin korrekt të rregullimeve ligjore në fushën e profesionit të kontabilistit, të rregullimeve dhe standardeve kombëtare e ndërkombëtare në fushën e kontabilitetit, të auditimit, të legjislacionit tatimor me qëllim për të përmirësuar raportimin financiar, transparencën ndaj publikut dhe kërkesat e Kodit të Etikes.
- te sigurojë që shërbimet e ofruara nga anëtarët e IKM të jenë në përputhje me kodin e etikës së IFAC dhe rregulloret në fuqi
- te sigurojë mbrojtjen e profesionit, të nderit e pavarësisë së anëtarëve të saj.
- te sigurojë edukimin e vijueshëm të anëtarëve të saj në fushën e profesionit në përputhje me kërkesat e Ligjit për Rregullimin e Profesionëve të Audituesve Ligjore dhe kontabilistëve të miratuar, të BMP dhe të IFAC.
- te zhvillojë veprimtari shkencore në shërbim të profesionit duke përpunuar, publikuar standarde të kontabilitetit dhe të organizimit të profesionit si dhe të marrë pjesë aktivitetet e organizuara në funksion të tij.

Neni 4

Anëtar i Shoqatës *behet* :

- a. Profesionisti, i punësuar ose i vetëpunësuar, i cili zotëron dëshminë si “Kontabilist i Miratuar” ose vërtetimet e provimeve të “Kontabilist i Miratuar”.
- b. Shoqëria e Kontabilitetit e cila është e organizuar si shoqëri tregtare, në përputhje me ligjin përkatës dhe administrohet nga një ose me shumë persona të cilët janë të pajisur me dëshminë e Kontabilistit të Miratuar dhe të cilët zotërojnë jo më pak se 50 për qind e të drejtave të votës në kapitalin e shoqërisë.
- c. Kandidati që aderohet për të marrë titullin “Kontabilist i Miratuar”.

Anëtarësimi në Shoqatë për personat e përmendur në germet “ a “, “ b “ dhe “ c “, behet në përputhje me dispozitat e nenit 30 të këtij Statuti.



Kapitulli II

Organizimi e drejtimi IKM

Seksioni 1

Te përgjithshme

Neni 5

Shoqata “Instituti i Kontabilistëve të Miratuar“, gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit në Gjykatë.

Ai mund t’u paraqesë organeve dhe autoriteteve shtetërore çdo kërkesë lidhur me profesionin që përfaqëson, si dhe të thirret nga këto organe e autoritete për çështje që kanë të bëjnë me këto profesion.

Neni 6

Administrimi i IKM bëhet nëpërmjet organeve që zgjidhen nga anëtarët e saj, sipas procedurave të përcaktuara në këtë Statut.

IKM vetëfinancohet. Burimet për financimin e aktivitetit të saj sigurohen kryesisht nga kuotat vjetore të anëtarëve të saj, nga veprimtaria trajnuese, botimet, kontribute të tjera nga donatore të brendshëm e të jashtëm, dhe burime të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Masa e kuotave vjetore të anëtarëve, shpërblimet e anëtarëve të organeve drejtuese e të komisioneve dhe buxhetet vjetore, miratohen çdo vit nga Asambleja e Përgjithshme e IKM, sipas përcaktimeve në nenet 40, 49 të këtij Statuti.

Neni 7

Organet e Drejtimit dhe të Kontrollit të brendshëm të IKM - se janë:

Asambleja e përgjithshme.

Këshilli i Drejtimit.

Presidenti i Shoqatës, i cili është njëkohësisht dhe Kryetar i Këshillit të Drejtimit.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm

Komiteti i Edukimit dhe Kualifikimit Profesional

Komiteti i Kontrollit të Cilësisë

Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës

Komiteti i Regjistrimit

Drejtori Ekzekutiv.

Këshilli i Kryetareve të Degëve dhe seksioneve.

Organet e drejtimit të Degëve dhe të Seksioneve.



Seksioni 2

Asambleja e Përgjithshme

Neni 8

Asambleja e Përgjithshme është organi me i larte i IKM.

Ajo përbëhet nga te gjithë personat e parashikuar ne nenin 4, qe kane kërkuar te jene anëtarë te Institutit, sipas nenit 4 te këtij Statuti dhe janë pranuar si anëtarë te saj.

Secili anëtar ka vetëm një mandat përfaqësimi dhe te drejtën e vetëm një vote ne Asamblenë e Përgjithshme. Te drejte vote ka anëtari qe ka paguar detyrimet e anëtarësisë te vitit ne vazhdim. Kandidatet kane te drejtën e ½ te votës.

Neni 9

Ne varësi te numrit te përgjithshëm te Kontabilisteve te Miratuar, Asambleja e Përgjithshme e anëtarëve mund te vendose qe Asambleja e Përgjithshme te përbëhet nga përfaqësues te zgjedhur nga anëtarët. (Një përfaqësues për çdo 10 anëtarë si dhe Kryetari i degës ose Përgjegjësi i Seksionit). Për Seksionet me më pak se 10 anëtarë do te zgjidhet një përfaqësues. Në rastet kur nga raporti del një numër me presje dhjetore si numër i përfaqësuesve do te jete numri i rumbullakosur (me shume se 0.5 merret numri pasardhës).

Mandati i përfaqësuesve te zgjedhur për ne Asamblenë e Përgjithshme është vjetor, me te drejte rizgjedhjeje.

Neni 10

Asambleja e Përgjithshme përcakton drejtimit kryesore te zhvillimit te veprimtarisë se IKM.

Ajo zgjedh dhe revokon anëtarët e Këshillit te Drejtimit, te Komitetit te Auditimit te Brendshëm, te Komitetit te Kontrollit te Cilësisë, dëgjon raportet e tyre, cakton kuotat e anëtarësisë, vendos për Buxhetin dhe llogarite, organigramen dhe çdo rregullim tjetër lidhur me organizimin profesional te parashikuar ne këtë Statut.

Asambleja e Përgjithshme miraton rregulloren e Kontrollit te Cilësisë te hartuar nga Komiteti i Kontrollit te Cilësisë.

Asambleja e Përgjithshme, ngarkon Këshillin e Drejtimit te miratoje rregulloret e hartuar nga komitetet e IKM sipas fushave qe mbulojnë, me përjashtim te rregullores se Kontrollit te Cilësisë.



Vendos për bashkim me organizma te tjerë profesionale, miraton projekt marrëveshje te Këshillit te Drejtimit për anëtarësim ne organizma ndërkombëtare, bashkëpunime me organizma te tjerë profesionale brenda dhe jashtë vendit etj.,

Asambleja e Përgjithshme e Shoqatës vendos për blerjen dhe shitjen e pasurive te paluajtshme te Shoqatës, me votat e jo me pak se gjysmës se anëtarëve te Asamblesë se Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme, para se te deklaroje shpërndarjen vullnetare te Shoqatës, vendos për mënyrën e shpërndarjes se pasurisë se paluajtshme ose te luajtshme te Shoqatës.

Shoqata shpërndahet me iniciativën e saj.

Vendimi për shpërndarjen e Shoqatës merret me miratimin unanim te te gjithë anëtarësisë se Asamblesë se Përgjithshme.

Iniciativa për shpërndarjen e Shoqatës merret nga jo me pak se një e treta e anëtarësisë se Asamblesë se Përgjithshme, e cila i paraqitet për shqyrtim Asamblesë se Përgjithshme.

Kërkesa me shkrim, për shpërndarjen e Shoqatës, duhet te parashtroje shkaqet dhe arsyet qe e bëjnë te pamundur vazhdimin e misionit për te cilin është krijuar Shoqata. Ajo duhet te ketë emrin, mbiemrin dhe firmën e secilit prej kërkuesve.

Asambleja e Përgjithshme vendos, me jo me pak se dy te tretat e anëtarësisë se saj, transformimin ose bashkimin e Shoqatës me Shoqata te tjera.

Vendos për ndryshimet statutore te IKM dhe ne përgjithësi vendos për çdo çështje te shkruar ne rendin e ditës.

Neni 11

Asambleja e Përgjithshme mblidhet te paktën një here ne vit, brenda nënte mujorit te vitit pasardhës, për te shqyrtuar e vendosur mbi veprimtarinë vjetore te Këshillit te Drejtimit, te Komitetit te Auditimit te brendshëm dhe te Komitetit te Kontrollit te Cilësisë.

Ajo mblidhet gjithashtu sa here qe është e nevojshme për IKM, kur një gjë e tille kërkohet nga te paktën 1/10 e anëtarëve, ose nga:

Kryetari i Këshillit te Drejtimit,

Shumica e thjeshte e anëtarëve te Këshillit te Drejtimit,

Kryetari i Komitetit te Auditimit te Brendshëm.

Neni 12

Rendi i ditës i Asamblesë se Përgjithshme caktohet nga autori i thirrjes, i cili ja dorëzon atë Sekretarisë se IKM te paktën 30 dite para datës se mbledhjes, për t'jua komunikuar anëtarëve te Asamblesë, te paktën 15 dite para datës se mbledhjes.

Ne komunikimin e rendit te ditës përcaktohet vendi, data e ora e mbledhjes. Ne raste urgjente afati i komunikimit mund te jete deri ne jo me pak se 10 dite para mbledhjes.

Asambleja e përgjithshme shqyrton vetëm çështjet e përcaktuara ne rendin e ditës.



Neni 13

Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme drejtohet nga Presidenti dhe në mungesë të tij nga Zv/Presidenti.

Sekretaria e mbledhjes se Asamblesë kryhet nga sekretaria e IKM.

Neni 14

Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme është e vlefshme kur marrin pjesë mbi 50% e anëtarëve me të drejtë vote ose të përfaqësuesve të tyre. .

Në rast se në një mbledhje nuk sigurohet kjo pjesëmarrje, atëherë mbledhja anulohet, për t'u bërë një mbledhje e dytë, të paktën brenda 15 ditëve me të njëjtin rend dite. Në mbledhjen e dytë vendimet merren nga anëtarët pjesëmarrës me të drejtë vote, ose përfaqësuesit, pavarësisht nga numri i tyre.

Vendimet e Asamblesë se përgjithshme merren me shumicë absolute të votave të vlefshme të anëtarëve të pranishëm, me votim të fshehtë: për zgjedhjen e organeve drejtuese dhe votim të hapur për çështjet e tjera. Në raste të veçanta Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që votimi të bëhet i fshehtë.

Neni 15

Mbledhjet e Asamblesë se përgjithshme dokumentohen me proces-verbale të mbajtura nga sekretaria e të nënshkruara edhe nga kryetari i mbledhjes.

Vendimet e marra nga Asambleja, përgatiten nga Sekretaria, nënshkruhen nga Sekretari dhe Kryetari i mbledhjes dhe ju dërgohen Degëve dhe Seksioneve jo më vonë se 30 ditë pas datës së mbledhjes së Asamblesë.

Degët, në mbledhjen e parë të radhës njoftojnë të gjithë anëtarët për këto vendime.

Seksioni 3

Këshilli i Drejtimit

Neni 16

Këshilli i Drejtimit siguron drejtimin e punës të IKM në periudhën midis dy mbledhjeve të Asamblesë, bazuar në këtë Statut, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe vendimet e Asamblesë se Përgjithshme, se cilës i raporton për veprimtarinë e tij.

Këshilli i Drejtimit ka për detyrë:

- të sigurojë mbrojtjen e profesionit
- të ndjejë respektimin e rregullave të etikës profesionale në përputhje me kërkesat e Kodit të Etikës të hartuar në koherencë të plotë me kodin e Etikës të IFAC dhe nën plotësimin e tyre në qoftë se është e nevojshme.



- të marre masa parandaluese të nevojshme, për të mënjanuar çdo akt të natyrës që zhvlerëson profesionin dhe në rast nevojë vendos masa ose sanksionet e duhura në përputhje me Rregulloren e Investigimit dhe Disiplinës pavarësisht gjyqimit civil apo penal.
 - të vendose për çdo çështje që i interesojnë profesionit të Kontabilistit të Miratuar.
 - të hartojë Rregulloret e funksionimit të brendshëm që ka në kompetencë sipas këtij statuti, organigramen e IKM, organigramen e Strukturës Ekzekutive dhe të Strukturave Drejtuese në rrethe.
 - Miraton rregulloret e hartuara nga Komitetet e ngritura pranë tij në zbatim të këtij statuti sipas detyrave që mbulojnë, përveç rregullores së Kontrollit të Cilësisë e cila miratohet nga Asambleja e Përgjithshme
 - Te sigurojë administrimin e pasurisë së IKM
 - Te sigurojë funksionimin e rregullt të IKM dhe të koordinojë veprimtarinë e organeve të saj.
 - Përzgjedh Drejtorin Ekzekutiv
 - të organizojë kurset përgatitore për kualifikimin profesional të kandidatëve të cilët do t'i nënshtrohen procesit të testimit për t'u pajisur me dëshminë "Kontabilist i Miratuar", për dëshmi të ngjashme
 - të organizojë dhe të monitorojë Edukimin e Vijueshëm të anëtarëve KM, të lëshojë dëshmi ose të çertifikojë kualifikimet e anëtarëve të tij, që organizon vetë ose nga të tjerë.
 - Të miratojë Komisionin e Regjistrimit si dhe të miratojë Rregulloren e regjistrimit të anëtarëve dhe kandidatëve për Kontabilist të Miratuar dhe Regjistrin e publikueshëm.
 - Te organizojë dhe ndjeko veprimtarinë e Degëve dhe Seksioneve në rrethe nëpërmjet strukturës ekzekutive.
- Këshilli i Drejtimit përfaqësohet nga një anëtar i tij në mbledhjet e Degëve dhe Seksioneve për zgjedhjen e organit drejtues, në analizat vjetore, si dhe kur kërkohet nga drejtimi Degës ose nga shumica e anëtarëve.
- Te përgatisë e zbatojë buxhetin e Institutit dhe t'i raportojë Asamblesë së Përgjithshme për plotësimin e buxhetit dhe për llogaritë vjetore.
 - Te përfaqësojë IKM-n pranë organeve shtetërore dhe palëve të treta.
 - Te bashkëpunojë me Ministrinë e Financave, Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, Bordin e Mbikëqyrjes Publike, Komisionin e Provimeve të Aftësive Profesionale, institucione dhe organizma të tjera në fushën e kontabilitetit, të legjislacionit, kualifikimit të vijueshëm profesional të anëtarëve të IKM-se, etj., dhe angazhohet në organizimin e zhvillimin e provimeve të aftësive profesionale të kandidatëve për Dëshminë "Kontabël i Miratuar".
 - Bazuar në Statutin e IKM, dhe në vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të hartojë Programet e punës, të organizojë dhe ndjekë zbatimin e detyrave të programuara.
 - Te vendosë për krijimin e Komiteteve të punës pranë Këshillit Drejtues dhe të ndjekë zbatimin e detyrave përkatëse.
 - Si rregull në krye të çdo Komiteti caktohet një anëtar i Këshillit Drejtues.



Neni 17

Këshilli i Drejtimit përbëhet nga 7 anëtarë ku me shume se gjysma janë Kontabiliste te Miratuar aktiv dhe strukturoret si me poshtë:

- Kryetar i Këshillit te Drejtimit qe është njëkohësisht dhe President i Shoqatës.
- Zv Kryetar i Këshillit te Drejtimit qe është njëkohësisht dhe Zv. President i Shoqatës.
- Anëtarë, 5 veta, përgjegjës për çështje te tjera, te ndara sipas fushës profesionale.

Anëtarët e Këshillit te Drejtimit, përveç një anëtari qe vjen automatikisht nga dega e IKM e Tiranës, zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme.

Presidenti dhe zëvendësit te tij, zgjidhen për një mandat 4 vjeçar me te drejte rizgjedhje vetëm një here.

Anëtarët e tjerë te Këshillit te Drejtimit zgjidhen për një mandat 4 vjeçar, me te drejte rizgjedhje vetëm pas kalimit te një mandati nga përfundimi i mandatit si i rizgjedhur.

Nuk mund te zgjidhen anëtarë te Këshillit te Drejtimit anëtarët e Institutit qe:

- Ne datën e mbledhjes se Asamblesë rezultojnë se nuk kane paguar kuotat e anëtarësisë.
- Ne datën e mbledhjes se Asamblese se përgjithshme nuk janë te regjistruar ne Regjistrin e Publikueshem te IKM;
- Ne datën e mbledhjes se Asamblese nuk plotësojnë 5 (pese) vite anëtarësi ne IKM si Kontabilist i Miratuar Aktiv;
- për katër vitet e fundit kane munguar dy here ne mbledhjet e asamblesë.
- Janë zgjedhur Kryetare Dege ose Përgjegjës seksioni ne rrethet përkatës. Përfashtohet nga ky kufizim kryetari i degës Tirane i cili pasi është zgjedhur nga anëtarësia e degës Tirane, është automatikisht anëtar i Këshillit te Drejtimit te IKM përveçse kur ka mbushur dy mandate radhazi ne drejtimin e degës.
- për dy vitet e fundit janë ndëshkuar me masa disiplinore nga organet drejtuese të IKM, nga BMP, nga organet administrative ose nga organet gjyqësore.

Zgjedhjet e anëtarëve te Këshillit te Drejtimit bëhen me votim te fshehte, ne baze te paraqitjes individuale me shkrim te kandidaturës. Paraqitja e kandidaturës behet pranë sekretarisë se Institutit te Kontabilisteve te Miratuar, jo me vone se pesëmbëdhjete dite para Mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme.

Kërkesa shoqërohet me një mbështetje te jo me pak se dhjete firma te anëtarëve te IKM.

Presidenti dhe zv/Presidenti zgjidhen ndërmjet anëtarëve te zgjedhur te KD, nga mbledhja e përbashkët e anëtarëve te Këshillit te drejtimit te zgjedhur dhe Këshillit te Kryetareve e Përgjegjësve te Seksioneve me votim te fshehte. Nga anëtarët e Këshillit te Drejtimit te zgjedhur propozohen katër kandidate dhe ne baze te rezultatit te votimit, kandidati me numrin me te madh te votave zgjidhet President dhe ne vijim Zv Presidenti.

Zgjedhjet organizohen nga një komision i përbërë prej jo më pak se 3 vetash i cili zgjidhet me votim ta hapur nga Asambleja.

Vendimi i komisionit zgjedhor për rezultatit e zgjedhjes së Këshillit Drejtues të IKM dhe të Presidentit dhe zv. Presidentit i dorëzohet Kryetarit te Mbledhjes se Asamblesë, i cili e shpall përpara mbylljes se Mbledhjes.



Funksionet e tjera te Këshillit te Drejtimit caktohen nga Presidenti i tij, ne marrëveshje me anëtarët e Këshillit te Drejtimit.

Neni 18

Këshilli i Drejtimit si rregull mblidhet një here ne dy muaj.

Mbledhjet e Këshillit kryesohen nga Presidenti ose ne mungese te tij, nga Zv Presidenti. Ne mungese te te dyve mbledhja e Këshillit te Drejtimit mund te kryesohet nga anëtari me i vjetër i Këshillit i pranishëm. Këshilli i Drejtimit mund te marre vendime kur janë te pranishëm jo me pak se 2/3 e anëtarëve. Mbledhja e Këshillit të Drejtimit zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën 5 anëtarë.

Vendimet merren me shumice absolute votash te anëtarëve te pranishëm. Ne rast votash te barabarta, vota e Kryetarit, ose ne mungese te tij, e zëvendës Kryetarit, është përcaktuese.

Anëtarët e Këshillit te Drejtimit, pjesëmarrës ne mbledhje, firmosin vendimet e miratuara.

Neni 19

Ne rast revokimi, vdekje, dorëheqje ose çdo rasti tjetër te pengimit te anëtarëve te Këshillit te Drejtimit, Asambleja e Përgjithshme mund te kooptoje, deri ne kryerjen e zgjedhjeve te ardhshme, një anëtar tjetër, nga kandidatet qe ne zgjedhjet e mëparshme ka fituar numrin me te madh te votave, por nuk ka qene zgjedhur anëtar i Këshillit te Drejtimit.

Bazuar ne sa sipër Këshilli i Drejtimit, brenda një muaji nga data e largimit te një anëtari te Këshillit, vendos caktimin provizor te kandidatit deri ne datën e mbledhjes se Asamblesë se përgjithshme.

Numri i anëtarëve te kooptuar nuk mund te jete me shume se dy. Ne qofte se krijohen me shume se dy vende vakant, atëherë Asambleja e Përgjithshme duhet te mblidhet, për te zgjedhur aq anëtarë sa mungojnë, përfshirë edhe anëtarët e kooptuar. Anëtarët e rinj te zgjedhur përfundojnë mandatin e anëtarëve qe kane zëvendësuar.

Neni 20

Presidenti përfaqëson Institutin ne marrëdhëniet me te tretet. Te gjitha dokumentet qe dalin nga IKM duhet te jene te nënshkruara nga Presidenti, ose ne mungese te tij, nga Zv. Presidenti.

Presidenti dhe ne mungese te tij Zv Presidenti, mund te autorizojnë anëtarë te IKM për lidhje kontratash me te trete ose për te përfaqësuar IKM ne marrëdhënie ne Institucione ose organizma te tjera.



Neni 21

DREJTORI EKZEKUTIV

Drejtori Ekzekutiv propozohet nga Presidenti i Shoqatës, nga çdo anëtar i Këshillit të Drejtimit dhe përzgjidhet, ndërmjet kandidaturave të paraqitura, nga Këshilli i Drejtimit dhe Këshilli i Kryetareve të Degëve dhe të Seksioneve.

Presidenti i Shoqatës emëron njërin prej tre kandidaturave të para.

Drejtori Ekzekutiv kryen administrimin ekonomik, financiar dhe veprimtarinë e përgjithshme ekzekutive, nëpërmjet strukturës ekzekutive të Shoqatës.

Ky administrim kryhet në përputhje me kompetencat dhe funksionet e përcaktuara në Rregulloren e Strukturës Ekzekutive e cila miratohet nga Këshilli i Drejtimit.

Rregullorja e Strukturës Ekzekutive, përcakton, por jo ekskluzivisht, si me poshtë:

- Mënyrën e funksionimit dhe përgatitjes, nga pikëpamja administrative, të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme, të Këshillit të Drejtimit, dhe të mbledhjeve të Këshillit të Kryetareve të Degëve-Seksioneve,
- Organizimin e sekretarisë së Asamblesë së Përgjithshme,
- Organizimin dhe zhvillimin e kurseve të kualifikimit,
- Mbajtjen e arkës dhe të evidencës kontabël,
- Kryerjen e pagesave sipas kompetencave,
- Ndjekjen e veprimtarisë së Degëve dhe seksioneve,
- Zbatimin e Programeve dhe Vendimeve të Këshillit të Drejtimit,
- Organizimin e strukturës ekzekutive dhe të emërimeve të stafit ekzekutiv të cilat miratohen nga Këshilli i Drejtimit.



Seksioni 4

Komiteti i Auditimit te Brendshëm

Neni 22

Komiteti i Auditimit te Brendshëm ka për detyre te verifikojë veprimtarinë financiare te IKM, pajtueshmërinë me aktet ligjore e nënligjore e me buxhetin e veprimeve te regjistruara ne llogari dhe rregullsinë e sinqeritetin e llogarive vjetore te IKM

Për verifikimet e kryera dhe rezultatet e nxjerra prej tyre, Komiteti i Auditimit te Brendshëm i paraqet raport Asamblesë se Përgjithshme te IKM. Anëtarët e Komitetit te Auditimit te Brendshëm nënshkruajnë bashkërisht raportin. Ne rast mosmarrëveshjes, secili prej anëtarëve paraqet veçmas mendimet e vlerësimet ne Asamblenë e Përgjithshme, e cila vendos përfundimisht.

Neni 23

Komiteti i Auditimit te Brendshëm përbëhet nga tre anëtarë te zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme, për një periudhe katër vjeçare. Ata mund te rizgjidhen, por jo me shume se një here.

Zgjedhja e anëtarëve te Komitetit te Auditimit te Brendshëm, behet me votim te fshehte, kundrejt paraqitjes individuale te kandidaturës, njëllonj si te procedurat e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Drejtimit. Kryetar i Komitetit caktohet kandidati qe fiton numrin me te madh te votave. Ne rast votash te barabarta, kryetar caktohet kandidati me i moshuar.

Ne rast revokimi, vdekje, dorëheqje ose çdo rasti tjetër te pengimit te anëtarëve te Komitetit te Auditimit te Brendshëm, procedura e zëvendësimit është e njëjte si për anëtarët e Këshillit te Drejtimit e përcaktuar ne nenin 19 te këtij Statuti.

Neni 24

Komiteti i Auditimit te Brendshëm mblidhet te paktën një here ne vit, për te shqyrtuar llogarite vjetore e për te përgatitur raportin lidhur me to, si dhe sa here qe gjykon te nevojshme vete, apo ne raste kur ngarkohet nga Këshilli i Drejtimit për probleme te veçanta.



Neni 24/1

Komiteti i Kontrollit te Cilësisë

Komiteti i Kontrollit te Cilësisë ka për detyre te verifikojë dhe kontrollojë cilësinë e shërbimeve te ofruara nga Kontabilistet e Miratuar, ne përputhje me ligjin Nr. 10091 date 05.03.2009, “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe te Kontabilistit te Miratuar“ i ndryshuar, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare te kontabilitetit, legjislacionin tatimor, rregullat e tjera qe lidhen me profesionin si dhe Kodin e Etikës profesionale.

Neni 24/2

Komiteti i Kontrollit te Cilësisë përbëhet nga 3 Kontabiliste te Miratuar, dy prej te cilëve janë anëtar te shoqatës ushtrues te profesionit dhe një te jete nga fusha akademike ose profesioniste te kontabiliteti apo auditimit qe nuk e ushtrojnë profesionin. Komiteti zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhe 2 vjeçare por jo me shume se 2 mandate.

Kryetar i Komitetit te Kontrollit te Cilësisë, caktohet anëtari qe ka fituar numrin me te madh te votave dhe ne rast votash te barabarta anëtarin me te moshuar.

Komiteti i Kontrollit te Cilësisë vepron ne baze te Rregullores te miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e shoqatës.

Neni 24/3

Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës

Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës, në zbatim të kërkesave të deklaratës së detyrimeve të anëtarësisë SMO – Nr. 6 të publikuar nga Bordi i IFAC-ut, si dhe të rregullores nr. 4 datë 29.03.2018 “Për Investigimin dhe Procedurat për Marrjen e Masave Disiplinore” të publikuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, ka për detyre:

- Investigimin e sjelljeve të këqija të Kontabilistet e Miratuar ose Shoqëritë e Kontabilitetit anëtarë te IKM mbi bazën informacioneve të besueshme ose programeve tematike, të autorizuara nga Këshilli Drejtues.
- Verifikimin e ankesave të paraqitura pranë IKM-s dhe BMP nga persona apo subjekte të tjera.

Neni 24/4

Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës është ne varësi te Këshillit te Drejtimit. Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës përbëhet nga 3 anëtarë, të cilët, zgjidhen nga radhët e



anëtarëve të IKM me një eksperiencë anëtarësie mbi 5 vjet dhe pa pasur masa disiplinore të marra nga IKM dhe caktohen me vendim të Këshillit të Drejtimit. Kryetari caktohet një anëtar i Këshillit të Drejtimit të IKM.

Çdo anëtar i Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës do të kenë një mandat emërimi 2 vjeçar me të drejtë rizgjedhje deri në dy mandate. Në rast të mbarimit të mandatit anëtarët e Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës do qëndrojnë në detyre deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj duke mos u kufizuar në ushtrimin e funksioneve të tyre deri në datën e zëvendësimit nga anëtarët e rinj.

Për të shmangur konfliktin e interesit anëtarët e komisionit duhet të konfirmojnë pavarësinë nga:

- a. Subjekti i kontrollit;
- b. Personat e lidhur ose të interesuar me rastin e kontrollit.

Në rastin e konfliktit të interesit anëtarët e komisionit duhet të tërhiqen menjëherë nga rasti duke u zëvendësuar përkohësisht nga një anëtar tjetër, i përcaktuar sipas procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës.

Organizimi dhe funksionimi i Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës së IKM-se bëhet përmes rregullores së hartuar nga Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës dhe që miratohet nga Këshilli i Drejtimit i IKM.

Neni 24/5

Komiteti i Regjistrimit

Komiteti i Regjistrimit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar” i ndryshuar dhe Rregullores Nr. 9 datë 27.02.2019 të BMP, është autoriteti i cili miraton regjistrimin dhe çregjistrimin e Kontabilisteve të Miratuar, shoqërive të kontabilitetit në Regjistrin e Publikueshem të anëtarëve të IKM si dhe regjistrimin dhe çregjistrimin e kandidatëve të cilët do t’i nënshtrohen testimit për marrjen e titullit “Kontabilist i Miratuar”

Neni 24/6

Komiteti i Regjistrimit është një strukturë në varësi të Këshillit të Drejtimit. Anëtarët e Komitetit të Regjistrimit zgjidhen nga Këshilli i Drejtimit. Komiteti përbëhet nga 3 anëtarë, ku njeri prej tyre nuk është Kontabilist i Miratuar dhe vjen nga fusha e jurisprudencës. Anëtarët e Komitetit të Regjistrimit zgjidhen për një periudhë 4 vjeçare me të drejtë rizgjedhje vetëm një here. Në rast të mbarimit të mandatit anëtarët e Komitetit të Regjistrimit do qëndrojnë në detyrë deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj duke mos u kufizuar në ushtrimin e funksioneve të tyre deri në datën e zëvendësimit nga anëtarët e rinj.



Neni 24/7

Komiteti i Edukimit dhe Kualifikimit Profesional

Komiteti i Edukimit dhe Kualifikimit Profesional ka për detyre të realizojë edukimin e vijueshëm të anëtarëve të saj, për të ruajtur dhe siguruar një cilësi sa më të lartë në kryerjen e shërbimeve që anëtarët e IKM ju ofrojnë klientëve dhe publikut, si dhe për përgatitjen e kandidatëve për dhënien e provimit përfundimtar të hyrjes në profesionin e “Kontabilistit të Miratuar” si dhe për të siguruar cilësi dhe nivel të lartë në këto kualifikime, në përputhje me Ligjin 10091 datë 5.3.2009 “Për Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesve ligjorë dhe të Kontabilistit të miratuar” i ndryshuar si dhe me kërkesat e IES dhe të IFAC.

Neni 24/8

Komiteti i Edukimit dhe Kualifikimit Profesional është një strukturë ndihmëse e Këshillit të Drejtimit dhe është në varësi të drejtpërdrejtë të tij. KEKP përbëhet nga 5 anëtarë, dy prej të cilëve nuk janë Kontabiliste të Miratuar dhe vijnë nga fusha akademike. Njeri prej anëtarëve është Kryetar i KEKP i cili duhet të jetë njëkohësisht anëtar i Këshillit Drejtues. Caktimi i anëtarëve të tjerë të KEKP bëhet nga Këshilli Drejtimit. Anëtarët dhe Kryetari i KEKP zgjidhen për një periudhë 4 vjeçare me të drejtë rizgjedhje një here. Në rast të mbarimit të mandatit anëtarët e Komitetit të Edukimit dhe Kualifikimit Profesional do qëndrojnë në detyrë deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj duke mos u kufizuar në ushtrimin e funksioneve të tyre deri në datën e zëvendësimit nga anëtarët e rinj. Mënyra e funksionimit përcaktohet në rregulloren e hartuar dhe të miratuar nga Këshilli i Drejtimit i IKM.

Seksioni 5

Organizimi i drejtimit në rrethe

Neni 25

Bazuar në numrin e anëtarëve të çdo rrethi, Këshilli i Drejtimit vendos krijimin e Degëve ose të Seksioneve përkatësisht. Seksionet krijohen në rrethe që kanë deri në 20 anëtarë. Disa Seksione në afërsi me njëri tjetrin mund të kërkojnë krijimin e Degës duke u bashkuar. Në këtë rast Përgjegjësit e Seksioneve janë njëkohësisht anëtarë të strukturës drejtuese të Degës, përveç anëtarëve të rinj që mund të zgjidhen.

Organet drejtuese të Degëve e Seksioneve zgjidhen me një mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhje vetëm një here, nga anëtarët e Degës ose Seksionit me votim të fshehte.



Neni 26

Organi drejtues i Degës është Kryesia e Degës e cila për behet nga 5 anëtarë, ne varësi te numrit te anëtarëve qe ka rrethi ose grup-rrethet ne afërsi.

Struktura e Kryesisë se Degës:

- Kryetar
- Zv/Kryetar
- Anëtar - 3 veta

Organi drejtues i Seksionit është Kryesia e Seksionit e cila përbëhet nga 3 anëtarë si vijon:

- Përgjegjës seksioni
- Anëtar - 2 veta

Zgjedhjet bëhen me po ato rregulla qe zgjidhet Këshilli i Drejtimit te IKM

Ne rast dorëheqjeje, vdekjeje ose çdo rasti tjetër te pengimit te kryerjes se funksionit te anëtarit te Kryesisë se Degës ose Seksionit, zbatohet procedura e zëvendësimit e parashikuar ne Nenin 19, si dhe rregullat e parashikuara, për këtë qellim, ne Rregulloren e hartuar dhe miratuar nga Këshilli i Drejtimit te Shoqatës.

Neni 27

Rregullorja e funksionimit te organeve drejtuese te Degëve dhe Seksioneve hartohet dhe miratohet nga Këshilli i Drejtimit i IKM.

Neni 28

Kryetaret e Degëve si dhe Përgjegjësit e Seksioneve ne rrethe, bazuar ne programet e IKM për veprimtaritë qe do te kryhen prej tyre, çdo vit hartojnë një projekt-buxhet për te mbuluar shpenzimet.

Këshilli i Drejtimit miraton shumat përkatëse te shpenzimeve ne Buxhetin vjetor dhe autorizon kryerjen e shpenzimeve sipas rregullores qe miratohet nga Këshilli i Drejtimit për këtë qellim.



Seksioni 6

Këshilli i Kryetareve te degëve dhe te seksioneve

Neni 29

Këshilli i Kryetareve te degëve dhe te seksioneve është organ këshillues i Këshillit Drejtues për probleme që janë parashikuar në këtë Statut.

Përbëhet nga Presidenti, Kryetaret e Degëve dhe Përgjegjësit e Seksioneve të zgjedhur nga anëtarët e çdo rrethi.

- Mblidhet një herë në tre muaj.

- Thirret dhe drejtohet nga Presidenti dhe në mungesë të tij nga zv Presidenti

- Përqendrohet në analizën e veprimtarisë së Degëve-Seksioneve, për probleme profesionale, të dispozitave ligjore, marrëdhënieve me organet tatimore, marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve, etj.

- Bazuar në programin vjetor të punës dhe në problemet që dalin në mbledhje, vendos për detyrat e degëve në tremujorin pasardhës.

- I propozon Këshillit të Drejtimit çështje për përmirësimin e drejtimit të veprimtarisë së IKM, përmirësimin e legjislacionit, kontabilitetit, etj.

Seksioni 7

Anëtarësia e IKM

Neni 30

Kërkesa për t'u anëtarësuar në IKM paraqitet nga të gjithë profesionistët që posedojnë Dëshminë "Kontabël i Miratuar", të lëshuar nga një organ i caktuar me ligj, nga IKM, ose nga organizma ekuivalente të njohur si dhe nga shoqëritë e kontabilitetit.

Dokumentet që duhen dorëzuar janë si mëposhtme:

a) Kontabilistët e Miratuar persona fizike, profesioniste të lire

- Kërkesë me shkrim për anëtarësimin në shoqatë

- Kopje e Dëshmisë Profesionale si Kontabilist i Miratuar (se noterizuar) ose kopje të noterizuar të vërtetimit të provimeve ose të dokumentit përkatës të parashikuar dhe të lëshuar nga ana e Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale

- Kopje të Dëshmisë së gjendjes gjyqësore e tre muajve të fundit

- Kopje e Diplomës së nivelit të dytë ose ekuivalente e saj (DIND)

- Kopje e dokumentit të identifikimit, pasaportë ose letër njoftimi,

- Dy fotografi.

b) Shoqëritë e Kontabilitetit

- Kërkesë me shkrim për anëtarësimin në shoqatë



- Kopje të NIPT-it (NUIS)
- Kopje e ekstraktit historik
- Kopje e Dëshmisë Profesionale si Kontabilist i Miratuar ortakut/ortakeve ose e administratorit
- Kopje të Vërtetimit të gjendjes gjyqësore e tre muajve të fundit
- Kopje e Diplomës e ortakut/ortakeve ose e administratorit
- Kopje e dokumentit të identifikimit, pasaporte ose letër njoftimi e ortakut/ortakeve ose e administratorit
- Listën e Kontabilistëve të Miratuar të shoqërisë

c) Kandidatet që aplikojnë për t'u pajisur me dëshminë "Kontabël i Miratuar", duhet të plotësojnë kërkesat e parashikuara në pikat "a", "b" dhe "ç", të nenit 16 të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.09, "Për Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesve Ligjore dhe të Kontabilistit të Miratuar" i ndryshuar

Ne kërkesë përveç të tjerave deklarohet "njohja e Statutit të IKM dhe angazhimi për zbatimin e tij".

- Kërkesat specifike në lidhje me dokumentacionin që duhet të paraqitet për regjistrim, përcaktohen në Rregulloren e "Regjistrimit dhe mbajtjes së Regjistrimit të anëtarëve", të miratuar nga Këshilli i Drejtimit.

Për kërkesat e paraqitura me mangësi, u kërkohet personave të interesuar që t'i plotësojnë.

Ne rast mos plotësimi brenda një muaji nga data e njoftimit i dërgohet shkresë ku tregohen dhe arsyet e mos regjistrimit si anëtar i IKM.

Neni 31

Kërkesat për anëtarësim si rregull paraqiten pranë Degëve ose Seksioneve të IKM, por dhe në Sekretarinë e IKM në qendër. Në këtë rast Sekretaria mbasi kryen veprimet e regjistrimit, një kopje të kërkesës ia dërgon Degës ose Seksionit përkatës.

Degët ose seksionet çdo muaj kërkesat e paraqitura me dokumentacionin lidhur ia paraqesin sekretarisë të IKM, duke mbajtur kopjen e kërkesës për efekte evidentimi.

Sekretaria të gjitha kërkesat për regjistrim ja paraqet Komitetit të Regjistrimit jo më vonë se 10 dite nga marrja e dokumentacionit të depozituar, i cili pasi shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur merr vendimin përkatës për pranimin ose jo të kërkesës për anëtarësim. Sekretaria pasi merr vendimin e Komitetit të Regjistrimit kryen veprimet e regjistrimit dhe njofton me shkrim Degën ose Seksionin për numrat e regjistrimit të anëtarëve të rinj. Bazuar në vendimin e Komitetit të Regjistrimit bëhet dhe përfshirja e emrit të amtarit në regjistrin publik të anëtarësisë.

Neni 32

Për Kandidatet që aplikojnë për pajisjen me dëshmi si "Kontabilist i Miratuar", shoqata harton programe të veçanta trajnimi në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 10091, datë



05.03.09, “ Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit te Audituesit Ligjor dhe te Kontabilistit te Miratuar” i ndryshuar.

Neni 33

Heqja e anëtarësisë nga IKM behet:

- Me kërkesë te anëtarit,
 - Kur anëtari nuk plotëson kushtet e anëtarësisë te përcaktuara ne Ligjin Nr. 10091, date 05.03.09, “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit te Audituesit Ligjor dhe te Kontabilistit te Miratuar“ i ndryshuar, Statutin e Shoqatës dhe rregulloret e saj,
 - Kryen veprime ne kundërshtim me Kodin e etikes profesionale, Statutin ose dispozitat ligjore ne fushën e profesionit.
 - Si rrjedhoje e masave te marra për shkeljet e konstatuara nga Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës
 - Ne rast se anëtari humb jetën
- Anëtari kandidat për KM humbet te drejtën për te aplikuar për marrjen e Dëshmisë Kontabël i Miratuar.

Neni 34

Shoqëria e kontabilitetit çregjistrohet nga regjistri publik i anëtarësisë:

- a) me kërkesën e saj të bërë nga administratori i shoqërisë;
- b) përfundon afatin e ushtrimit të veprimtarisë së parashikuar në statutin e vet;
- c) e drejta për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri kontabiliteti hiqet si rrjedhoje e masave disiplinore te marra nga Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës, shkeljeve te tjera ligjore ne fushën e profesionit, ose si rezultat i heqjes se statusit nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

Neni 35

Procedurat për pezullimin ose tërheqjen e anëtarësisë nga IKM përcaktohen ne “Rregulloren e Regjistrimit dhe te Mbajtjes se Regjistrit te Anëtarëve “, e cila miratohet nga Këshilli i Drejtimit.



Kapitulli III

Detyra e te drejta te anëtarëve te Institutit

Neni 36

Sigurimi i ruajtjes se pavarësisë e te nderit te IKM dhe dhënia e autoritetit te duhur veprimtarisë se anëtarëve te vet, kërkon nga anëtarët:

- kompetenca e ndërgjegje profesionale,
- bindje e dinjitet,
- pavarësi morale e materiale,

Çdo anëtar i IKM bën përpjekje për zhvillimin e cilësive te mësipërme dhe zbatimin e tyre ne çdo rast, madje edhe ne jetën private, duke vepruar ne pajtim me etiken profesionale, dispozitat ligjore e nënligjore ne fuqi dhe ne traditat e vendit.

Ai duhet te jete i ndershëm dhe i paanshëm, te karakterizohen nga mirësjellja, bashkëpunimi e ndihma reciproke me profesionistet e tjerë.

Anëtari i IKM duhet te përpiqet te zgjidhe ne mirëkuptim çdo mosmarrëveshje me koleget e tij dhe ne se nuk e arrin ketë te njoftoje Presidentin, i cili luan rolin e arbitrit për një rregullim pajtues.

Neni 37

Anëtarët e IKM-s duhet te zbatojnë rregullat e Kodit te Etikes profesionale i cili hartohet ne pajtim me Kodin e Etikes se Federatës Ndërkombëtare te Kontabilisteve dhe te miratuar nga Asambleja e Shoqatës dhe dispozitat e këtij Statuti, veçanërisht:

- te plotësojë dokumentacionin e kërkuar dhe evidencat përkatëse
- te paguaje brenda afateve te caktuara detyrimet e anëtarësisë
- te plotësojë kërkesat e edukimit te vijueshëm profesional te përcaktuara ne Ligjin Nr. 10091, date 05.03.09, “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit te Audituesit Ligjor dhe te Kontabilistit te Miratuar“ i ndryshuar dhe Rregulloren Nr. 9 date 27.02.2019 “Për Rregullimin dhe Mbikëqyrjen e Funkcionimit të Organizatave Profesionale dhe Profesionit të Kontabilistit të Miratuar” e ndryshuar, dhe kërkesa te tjera te miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqatës.

Neni 38

Kontabilisti i miratuar mban Regjistrin profesional, ku shënon te gjitha shërbimet e punimet e kryera prej tij.



Formati i Regjistrimit caktohet me vendim të Këshillit Drejtues.

Neni 39

Anëtarët e IKM për çdo kontratë për kryerjen e shërbimeve e në zbatimin e saj, krijojnë dosje të veçante me të dhëna të plota sipas Formatit të miratuar nga Këshilli i Drejtimit. Kjo dosje do të ruhet për një afat pesëvjeçar dhe e paraqet sa here i kërkohet nga organet drejtuese në qendër, degë apo seksion me autorizimin e Këshillit të Drejtimit.

Neni 40

Anëtarët e IKM paguajnë një kuotë profesionale vjetore:

- Kuotë Fikse, qe:

- për anëtarët KM që nuk janë në regjistrin aktiv nuk mund të jete me pak se 5,000 leke.

- për anëtarët KM që janë në regjistrin aktiv të IKM nuk mund të jete me pak se 10,000 leke.

- për kandidatë për KM nuk mund të jete me pak se 2,000 leke.

- Kuotat e anëtarësisë mund të ndryshojnë me vendim të Asamblesë të Përgjithshme

- Këshilli i Drejtimit cakton afatin dhe mënyrat e mbledhjes së kuotave në përputhje edhe me kërkesat në fuqi nga BMP.

Për vitin e parë të regjistrimit anëtarët e rinj, paguajnë Kuotën fikse e cila paguhet në përpjesëtim me periudhën e mbetur deri në fund të vitit.

Kapitulli IV

Masat disiplinore dhe procedurat e ankesave

Neni 41

Për shkeljen e Rregullave të Profesionistit “Kontabilist i Miratuar” të dispozitave ligjore si dhe të këtij Statuti, Këshilli i Drejtimit vendos masat disiplinore si vijon:

1. Këshillim.
2. Qortim.
3. Vërejtje me shënim në dosje.
4. Gjore



5. Heqja e anëtarësisë nga IKM.

Masat disiplinore vendosen sipas procedurës të parashikuar në Rregulloren e Investigimit dhe Disiplinës.

Neni 42

Ankimet e drejtuara kundër një anëtar të Shoqatës, të ardhura nga organet shtetërore, biznesi apo individ të ndryshëm, të cilët kanë të bëjnë me veprimtarinë e tij në fushën e profesionit, i paraqiten Kryetarit të Këshillit të Drejtimit, i cili, brenda 10 ditëve, ja paraqet Komitetit të Investigimit dhe Disiplinës, “ për kryerjen e verifikimeve të duhura si dhe për përgatitjen e raportit përkatës.

Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës, menjëherë pas mbledhjes për shqyrtimin e çështjes, njofton, anëtarin objekt të ankesës, për paraqitjen e tij pranë Komitetit për të dhënë shpjegimet e nevojshme.

Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës, paraqet, brenda 30 ditëve në përputhje me Rregulloren përkatëse dhe pasi ka kryer investigimet e nevojshme, në Këshillin e Drejtimit, raportin përkatës ndaj ankesës së bashku me propozime konkrete.

Këshilli i Drejtimit, pasi shqyrton ankesën dhe Raportin e Komitetit të Investigimit dhe Disiplinës, vendos me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

Neni 43

Brenda një muaji nga data e paraqitjes së raportit përkatës për çështjen në shqyrtim, Presidenti fton në mbledhjen e Këshillit të Drejtimit, anëtarin e IKM objekt i ankesës dhe autorin e ankesës, nga i cili mund të kërkohej paraqitja gojore e ankesës.

Në rast mos paraqitje, shqyrtimi bëhet në bazë të dokumentacionit të paraqitur.

Njoftimi për mbledhjen e Këshillit për anëtarët dhe të ftuarit bëhet të paktën 10 ditë para datës së mbledhjes.

Kontabilisti i Miratuar, objekt i ankesës, ke të drejte të njihet me dosjen përkatëse dhe të marrë edhe këshilltar për mbrojtjen e tij.

Neni 44

Këshilli i Drejtimit, përveç raportit me shkrim, mund të kërkojë Komitetit të Investigimit dhe Disiplinës edhe një paraqitje gojore të çështjes në shqyrtim



Ai mund të dëgjojë gjithashtu edhe dëshmitarë të tjerë ose të kërkojë paraqitjen e të dhënave të tjera, nëse është e nevojshme.

Kontabilisti i Miratuar, objekt i ankesës, mund të paraqesë argumentet e tij, me shkrim ose me gojë.

Neni 45

Vendimi i Këshillit të Drejtimit u behet i ditur personave të interesuar brenda pesëmbëdhjete ditëve nga data e mbledhjes që ka shqyrtuar çështjen.

Kundër këtij Vendimi mund të behet ankimim brenda 15 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane.

KAPITULLI V

Buxheti, Llogaridhënia

Neni 46

Brenda muajit shkurt të çdo vitit, Struktura Ekzekutive (zv/Drejtori), i paraqet Këshillit të Drejtimit:

- llogarite vjetore për vitin e mbyllur
- projekt buxhetin për vitin e ri.

Këshilli i Drejtimit vendos për llogarite vjetore që do t'i paraqiten Asamblesë së Përgjithshme, të cilat duhet të japin një pamje besnike të pasurisë, të gjendjes financiare e të ardhurave e shpenzimeve për vitin e mbyllur.

Te paktën dy muaj para datës së caktuar për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, llogarite vjetore i jepen për verifikim Komitetit të Auditimit të Brendshëm, i cili duhet të depozitojë raportin një muaj para datës së mbledhjes.

Llogarite vjetore, raporti i Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe Projekt-Buxheti i bashkëlidhen vendimit të Asamblesë së Përgjithshme që i ka shqyrtuar dhe miratuar ato.

Neni 47

Votimi i buxhetit behet për tërësinë e tij duke caktuar edhe kuotat përkatëse për shumatat e marra në konsideratë për hartimin e buxhetit të të ardhurave.

Në kufijtë e buxhetit për të ardhurat e shpenzimet e miratuara për një ushtrim, Këshilli i Drejtimit është i autorizuar të mbledhë të ardhurat e të kryeje shpenzime edhe gjatë gjashtë muajve të parë të ushtrimit vijues.

Teprica e të ardhurave mbi shpenzimet e çdo viti mbartet në vitin pasardhës ose mund të kalojë në rezervën e përgjithshme apo në një rezervë speciale, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast se në ndonjë ushtrim shpenzimet rezultojnë



me të mëdha se të ardhurat, teprica kalon në pakësim të rezervave ose mbartet për ushtrimin e ardhshëm, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 48

Këshilli i Drejtimit cakton rregullat e mbajtjes së llogarive, të inventarizimit dhe rregullat e vlerësimit të pasurisë. Këshilli i Drejtimit cakton mbajtësin e llogarive të propozuar nga Drejtori Ekzekutiv.

Neni 49

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme anëtarëve të Këshillit të Drejtimit, të Komitetit të Auditimit të Brendshëm, Komitetit të Kontrollit të Cilësisë ju caktohet një shpërblim fiks për pjesëmarrje në veprimtari të secilit. Pagat për komitetet e krijuara nga KD, për anëtarët e Komiteteve si dhe për stafin ekzekutiv, caktohen nga Këshilli i Drejtimit.

Neni 50

Për sa nuk është trajtuar në këtë Statut zbatohet legjislacioni përkatës në fuqi.

Neni 51

Ky Statut u redaktua në pesë ekzemplare origjinale, duke pasur secili fuqi të barabartë ligjore, nga të cilët një ekzemplar depozitohet në Zyrën e Notarisë Tirane, një ekzemplar depozitohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane dhe tri ekzemplare depozitohen në selinë e Shoqatës “ **INSTITUTI I KONTABILISTEVE TË MIRATUAR** “.

Miratuar në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme

Date 28.12.2020.

Asambleja e Përgjithshme
Kryetari i mbledhjes
Presidenti i Shoqatës

Sotiraq DHAMO